



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:242275  
Datë: 25.04.2024  
Numri i dokumentit: 05621310

A.C.nr.129/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtar, në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson M. K., kundër të paditurit N. Z., nga Prishtina, Rr. “Z. S.”, 3/A, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. F. M. nga Prishtina, për shkak të rimbursimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3007/2015 datë 23.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 22.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurit N. Z., nga Prishtina, Rr. “Z. S.”, .../A, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3007/2015 datë 23.10.2020, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.3007/2015 datë 23.10.2020, ka vendosur: I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, dhe OBLIGOHET i padituri N. Z. nga Prishtina, Rr. “Z. S.”, 3/A, që paditëses t’ia rimbursojë shumën prej 215.00 €, në emër të pagesës për kompensimin e dëmit të dëmtuarit B. A. të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 12.11.2012, me kamatë sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, të cilat paguhen në bankat komerciale në Kosovë e cila fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. II. Obligohet i padituri që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 15 euro, në emër të taksës gjyqësore.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjorë ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që ta aprovoj si të bazuar ankesën dhe ta ndryshoj aktgjykimin a ankimuar ashtu që ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar kërkesë padinë e paditëses, apo të njëjtin ta prishë dhe lëndën ta kthej në riprocedurë dhe ri vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësja, edhe pse e njëjta me kohë është njoftuar me ankesën e të paditurit.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë në bazë të nenit 194 dhe nenin 195, të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore gjeti se:

*-Ankesa është e të paditurit është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, me datë 10.12.2015, pranë gjykatës së shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurit N. Z. nga Prishtina, me kërkesë për rimbursim të dëmit në lartësi prej 215.00 euro si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, ka mbajtur seancën për shqyrtim kryesor dhe pas administrimit të këtyre provave ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.3007/2015 datë 23.10.2020, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesë padinë e paditëses, duke vendosur më konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë mes tjerash ka arsyetuar se: Duke u nisur nga koha e ndodhjes së raportit juridiko-detyrimor, Gjykata gjen se ligj i aplikueshëm në këtë çështje kontestimore është Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Nr. 29/78, 39/85, 45/89, Fletorja zyrtare e RFJ nr. 31/93 e dt. 18.06 1993). Meqë i padituri në përgjigje në padi dhe në shqyrtimin kryesor është thirrë në parashkrim të kërkesës, gjykata fillimisht ka shqyrtuar çështjen e parashkrimit. Pasi që kemi të bëjmë me një afat të natyrës materialo-juridike, për të cilin konform dispozitës së Nenit 360 par.2 të LMD-së gjykata e merr parasysh vetëm nëse pala thirret në atë - Gjykata fillimisht u lëshua në shqyrtimin e afatshmërisë së kërkesës, respektivisht në vlerësimin e afatit të parashkrimit të kërkesës. Me Nenin 376 par.1 të këtij Ligji, parashihet se *“Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin. Kurse me paragrafin 2 të këtij neni parashihet se “Sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi”*. Gjykata sqaron se dispozita e lartcekur vlen në raport të dëmtuarit për të kërkuar kompensimin ndaj dëmtuesit dhe nuk nënkupton se parashkrimi i kërkesës së paditëses ndaj të paditurit për rimbursim fillon të rrjedhë nga dita e shkaktimit të dëmit.

Më tej ka arsyetuar se: Në rastin e kërkesës së paditëses për rimbursim, Ligji ka paraparë dispozitë të veçante me nenit 939 par.1, me të cilën parashihet se *“Me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguarit ndaj personit i cili mbi cilën bazë qoftë është përgjegjës për dëmin”*. Ndërsa me Nenin 361 të LMD-së parashihet se: *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit në qoftë*

*se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër.* Andaj, nga dispozita e lartcekur del përfundimi se në rastin konkret raporti detyrimor i siguruesit ndaj pronarit të mjetit motorik të pasiguruar, respektivisht shkaktarit të dëmit, lind në momentin kur siguruesi e ka kompensuar të dëmtuarin dhe jo nga momenti kur i padituri ta ketë shkaktuar dëmin. Andaj, kërkesa për rimbursimin e dëmit parashkruhet në afat prej tre vitesh dhe fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur siguruesi ta ketë kompensuar të dëmtuarin.

Më tej ka arsyetuar se: Nga gjendja faktike e vërtetuar si më lartë, në bazë të provave të administruara, Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar. Kjo për faktin se Gjykata ka vërtetuar se në rastin konkret i padituri ka qenë përgjegjës për shkaktimin e aksidentit të komunikacionit të datës 12.11.2012, ku ka goditur automjetin e të dëmtuarit B. A.. Këto fakte Gjykata i ka vërtetuar nga raporti i policisë si provë materiale vendimtare në këtë çështje kontestimore të cilave Gjykata i'a fali besimin. Së këndejmi, paditësja e ka kompensuar të dëmtuarin (B. A.), për dëmin e shkaktuar nga i padituri, i cili në momentin e shkaktimit të aksidentit nuk ka pasur mbulesë siguruese – fakte këto të cila janë vërtetuar nga ujdia jashtë gjyqësore dhe transferi bankar. Tani paditësja ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e dëmit nga ana e personit i cili e ka shkaktuar këtë aksident, që sipas raportit të policisë është i padituri.

Më tej ka theksuar se: Nga të lartcekurat, Gjykata gjen se në paditësin kanë kaluar të gjitha të drejtat që të kërkojë rimbursimin e pagesës së kompensimit të dëmit konform dispozitave të nenit 9 të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, nenit 960 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve e në pajtim me kushtet për sigurimin e automjetit nga auto përgjegjësia për dëmin e shkaktuar personave të tretë. Sipas nenit 18 par.1 Ligji mbi sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia është paraparë se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”* Sipas par. 4 të Nenit 18 *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*. Kjo e drejtë paditëses i garantohet edhe me dispozitën e nenit 939 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, e cila u citua më sipër. Andaj, nga dispozitat e lartcekura, e duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, Gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për regresimin e dëmit paditëses, pasi që paditësja ‘ia ka kompensuar dëmin të dëmtuarit të shkaktuar nga ana e të paditurit – gjë që u vërtetua nga fletëtransferi i mjeteve të deponuara për të dëmtuarin. Andaj, nga të lartcekurat, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi për gjykuar, është marrë në kuptim të nenit 277 të LMD-së së vitit 1978.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 452.1 dhe 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por as me shkelje të cilat pretendohen me ankesë.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të paditurit se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me të meta thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ngase Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare duke vërtetuar se i padituri e ka shkaktuar dëmin me fajin e tij dhe paditësja e ka kompensuar këtë dëm sipas rregullave për kompensimin e dëmit për automjetet e pa siguruar sipas sigurimit nga auto-përgjegjësia.

Gjithashtu, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të paditurit për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara e ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses është vërtetuar me provat materiale të bashkangjitur në lëndë, e nga të cilët është vërtetuar se i padituri me dt.12.11.2012 me automjetin VË PASSAT, me targa të regjistrimit ...-...-CD ka shkaktuar aksident komunikacioni në Prishtinë, ku ka goditur Automjetin F. me targa të regjistrimit ...-5...-CH, pronë e B. A. I padituri ka qenë i pasiguruar, respektivisht i ka skaduar afati i periudhës së sigurimit. Si pasojë e kësaj, i dëmtuari B. A. ka bërë kërkesë për kompensim dëmi te paditësja, fakte këto të vërtetuara nga provat që gjinden në shkresat e lëndës, por që edhe i padituri nuk e ka kontestuar asnjëherë bazën në kuptim të mënyrës së shkaktimit të aksidentit. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar edhe lartësinë e kërkesës kur ka vërtetuar se paditësja në procedurë jashtëgjyqësore, përkatësisht sipas ujdisë jashtë gjyqësore të datës 04.12.2012, ka kompensuar dëmin e shkaktuar nga i padituri palës së dëmtuar në lartësi prej 215.00 euro, dëm ky i paguar sipas urdhër transferit të datës 26.12.2012, përmes së cilit mjetet në lartësi prej 215.00 euro janë transferuar tek i dëmtuari.

Të pa bazuara janë pretendimet ankimore të paditurit, për zbatim të gabuar të drejtës materiale pasi që sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, mbi bazë të gjendjes faktike të konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë drejtë është zbatuar e drejta materiale. Për faktin se me dispozitën e nenit 154 është paraparë se “kush tjetrit i shkakton dëm e ka për detyrë të ia shpërblej dëmin vetëm nëse provon se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Po ashtu e paditura ka të drejtën e rimbursimit të dëmit të paguar për automjetet të cilat nuk kanë pasur sigurim të detyrueshëm nga auto përgjegjësia sikurse në rastin konkret sipas nenit 4.6 Rregulla 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë, parasheh: “Në rast të dëmit të shkaktuar si pasojë e përdorimit të automjetit, ku pronari është dashur por nuk ka kontraktuar sigurimin e detyruar të autopërgjegjësisë-, zhdëmtimi paguhet deri në të njëjtën shumë dhe sipas të njëjtave kushte sikur të ekzistonte sigurimi i detyrueshëm i autopërgjegjësisë” ndërsa më tej parasheh që “Pas pagimit të dëmshpërblimit, mund të bëhet rimbursimi i shumës së paguar në bazë të kërkesës për regres nga pronari apo shfrytëzuesi i regjistruar i automjetit i cili nuk e ka siguruar

*automjetin, duke llogaritur këtu edhe kamatën me shpenzime*”. Në rastin konkret i padituri është përgjegjës për kompensimin e dëmit të përcaktuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit vlerëson si të pa bazuar pretendimet ankimore të të paditurit në lidhje me parashkrimin e kërkesës së paditësit, pasi që në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, pasi që paditësja me kohë e ka parashtruar padinë e sajë në gjykatë me qëllim të kompensimit të dëmit. Andaj, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vlerësuar parashkrimin kur ka konstatuar se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, pasi që padia e paditëses është ushtruar brenda afatit tre vjeçare përkatësisht me datë 10.12.2015, ndërsa pagesa e dëmit nga paditësja është bërë me 26.12.2012 që nënkupton se e njëjta kërkesë është në kohë. Andaj në rastin konkret afati i parashkrimit të kërkesës ka filluar të rrjedhë ditën e parë nga dita kur paditësja ka bërë pagesën e dëmit tek pala e dëmtuar që nënkupton se dita e parë e fillimit të rrjedhjes së afatit të parashkrimit është dita 27.12.2012 dhe deri në parashtrimin e padisë nga ana e paditëses me datë 10.12.2012, nuk kanë kaluar tre vite dhe në raste të tillja janë të pa pranuar pretendimet e të paditurit që afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga dita e shkaktimit të aksidentit, pasi që në këtë raste si ditë e shkaktimit të dëmit për paditësit është dita kur është kompensuar i dëmtuari dhe jo dita kur është shkaktuar aksidenti.

Gjykata e Apelit i vlerësoj edhe pretendimet tjera ankimore të të paditurit të parashtruar në ankesë, por të njëjtat nuk i mori për bazë, pasi që nuk kishin ndikim në vendosjen ndryshe në ankesën e të paditurit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është konform nenit 452.1 të LPK-së, pasi që shpenzimet e aprovuara janë shpenzime të domosdoshme për zhvillimin e procedurës kontestimore.

Nga të cekurat më lartë, e duke u mbështetur në nenin 194, 195 parag.1 pika d), 200 të LPK-së, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË  
AC.nr.129/2021 datë 22.04.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari  
Besnik Bislimaj, d.v